



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura V

Sesioni pranveror

Komisioni për Arsim, Shkencë, Teknologji, Kulturë, Rini dhe Sport

Mbledhja nr.77

Prishtinë, më 17.1.2017, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, salla N-302

PROCESVERBAL

**I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR ARSIM, SHKENCË, TEKNOLOGJI,
KULTURË, RINI DHE SPORT**

Në mbledhje morën pjesë: Nait Hasani, kryetar, Salih Morina, Bekim Haxhiu, Ismajl Kurteshi Shpejtim Bulliqi, Teuta Haxhiu dhe Shukrije Bytyçi.

Munguan: Sergjan Popoviç dhe Mufera Shinik.

Përfaqësues të ftuar:

Përfaqësues të tjerë: përfaqësuesit e Këshillit Rinor, KDI, OSBE dhe mediat.

Stafi Mbështetës i Komisionit: Lule Ymeri dhe Shaip Goxhuli.

Mbledhjen e kryesoi Nait Hasani, kryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

- 1. Miratimi i rendit të ditës;**
- 2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.12.2016;**
- 3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë;**
- 4. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës;**
- 5. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017;**
- 6. Të ndryshme.**

Kryetari konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës së Komisionit dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të ditës.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa vërejtje.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 27.12.2016;

Anëtarët e Komisionit miratuan procesverbalin e mbledhjes së datës 27.12.2016.

3. Shqyrtimi në parim i Projektligjit për Ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë

Kryetari i Komisionit, Nait Hasani njoftoi anëtarët e Komisionit se Projektligji për Ratifikimin e marrëveshjes për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës e Hercegovinës dhe Serbisë, të shtyhet për mbledhjen e radhës së Komisionit, propozim i cili u miratua nga anëtarët e tij.

4. Shqyrtimi i Projektligjit për Inspektoratin e Arsimit në Republikën e Kosovës

Sa i përket kësaj pike të rendit të ditës, Nait Hasani propozoi që të mbahet një takim me kryeministrin dhe ministrin e MASHT-it, me qëllim të konsultave shtesë për nevojën e ndryshimin eventual të projektligjit. Komisioni duhet të organizojë dëgjime publike me zyrtarët e drejtorive komunale në Republikën e Kosovës, duke u organizuar në shtatë rajonet e vendit, propozim i cili u përkrah nga anëtarët e Komisionit.

Teuta Haxhiu, tha se Inspektorati është një mekanizëm mjaftë i rëndësishëm dhe ai duhet të mos jetë nën ombrellën e MASHT-it, pasi që vetëm në këtë mënyrë, mund të presim rezultate konkrete nga ky institucion.

Ismajl Kurteshi, tha se ky është projektligji më i rëndësishëm për këtë vit, që Komisioni do të shqyrtojë, dhe si i tillë, duhet të diskutohet në të gjitha rajonet e Kosovës.

Shukrije Bytyçi, propozoi vizitë studimore në Shqipëri, duke e konsideruar si një model të mirë të institucionit të Inspektoratit dhe i cili do të mund të aplikohet edhe në Kosovë.

Salih Morina, sa i përket Projektligjit për Inspektoratin, theksoi se ne duhet të marrim praktikën dhe përvojat më të mira nga vendet e Ballkanit, dhe si rrjedhojë, duhet të gjenden modele të përshtatshme dhe të aplikueshme që Inspektorati të jetë funksional dhe i suksesshëm.

Bekim Haxhiu, propozoi që të ketë diskutimi me ministrin, në lidhje me nevojën e rishikimit të plotë të politikave dhe orientimeve të MASHT-it, se cilin model duhet të inkorporojmë dhe aplikojmë në vendin tonë, pasi që sipas tij, nuk po ka uniformitet në zbatimin e legjislacionit për arsimin në Kosovë.

5. Shqyrtimi i planit të punës së Komisionit për vitin 2017

Nait Hasani, prezantoi planin e punës së Komisionit, duke thënë se për këtë vit është paraparë që të shqyrtohen këto projektligje: Projektligji për Ratifikimin e për themelimin e Zyrës Rajonale për Bashkëpunim Rinor në mes Kosovës, Shqipërisë, Bosnjës dhe Hercegovinës dhe Serbisë; Projektligji për Inspektoratin e Arsimit; Projektligji për inovacion, transfer të dijes dhe të teknologjisë; rishqyrtimi i Projektligjit për Diasporën dhe Projektligji për botimin e teksteve dhe mjeteve mësimore, lektyrave dhe dokumentacionit pedagogjik. Me këtë rast, tha se datat e paraqitura nga sponsorët e projektligjeve, nuk japin mundësinë e shqyrtimit me kohë të tyre, pasi që janë afate shumë të shkurtra, dhe si të tilla, duhet të diskutojnë me përfaqësuesit e këtyre ministrive për mundësinë e ricaktimit të datave.

Bekim Haxhiu, tha se plani i punës për vitin 2017, është një plan i mangët, i hartuar nga ministrinë e linjës, pavarësisht zotimeve të tyre për një vëllim më të madh të punëve për këtë vit. Ai tha se Ministria ishte dashur të përfshinte në planin e saj edhe Projektligjin për menaxhimin dhe sigurimin e objekteve sportive, pasi që sipas tij, nga mosmenaxhimi i këtyre objekteve, ato po rrezikohen dhe se siguria në to është shumë e brishtë. Ai theksoi se do të ishte mirë që si Komision, të marrim iniciativë për hartimin e këtij projektligji, por në rast se nuk ka gatishmëri, atëherë ai do ta iniciojë vetë këtë çështje.

Shpejtim Bulliqi, ngriti çështjen e nevojës së rishikimit të Ligjit për arsimin parauniversitar, duke thënë se ky ligj ka nevojë për amendamentimin. Ai u shpreh i gatshëm që të ofrojë përvojën dhe informacionet e nevojshme, me qëllim të përmirësimit të këtij ligji.

Më tej, në këtë pikë, të gjithë anëtarët e Komisionit u dakorduan që t'u kërkojnë ministrive sponsorizuese të projektligjeve për vitin 2017, që të rishikojnë mundësinë e ricaktimit më të hershëm të afateve të parapara, sepse aktualisht, me afatet e paracaktuara, ato nuk do të mund të diskutoheshin dhe të trajtoheshin nga Komisioni.

6. Të ndryshme

Në këtë pikë, Ismajl Kurteshi i njoftoi anëtarët e Komisionit se grupi i tij parlamentar, do të mbajë interpelancë, sa i përket gjendjes në fushën e arsimit, po ashtu edhe takimin e organizuar me ekspertët e arsimit, që për temë diskutimi ka gjendjen në arsim.

Teuta Haxhiu, tha se është mirë që si Komision të interesohen dhe kërkojnë llogari për tërheqjen e Ligjit për arsimin e lartë, dhe sipas saj, kjo përbën shkelje procedurash dhe afatesh.

Bekim Haxhiu, ngriti dy çështje. E para kishte të bënte me aranzhimin e takimit me rektorët e universiteteve publike në Kosovë, që të diskutonin për statutet e këtyre universiteteve dhe cilësinë në universitete, sepse sipas tij, ato nuk janë në përputhje me Ligjin për arsimin e lartë, si dhe me Ligjin për shërbimin civil dhe atë të punës. Ndërkaq, çështja e dytë, kishte të bënte me Agjencinë e Akreditimit, ku sipas tij, janë bërë hapa të mirë, por që ka vështirësi në zbatimin e tyre. Në vazhdim të diskutimit të tij, shtoi se duhet të ketë monitorim të provimit përfundimtar për profesionet e rregulluara me ligj dhe theksoi se monitorimi do të ndikojë në rritjen e cilësisë,

ku njëra prej formave duhet të jetë digjitalizimi dhe monitorimi i provimit të maturës, formë e cila do të shmangte edhe ndërhyrjet eventuale në të.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

E përgatiti:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Nait Hasani